




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. Nr. Ifaq Broj stranica Nr. pages	2-D / DPK 02 Nr. Prot. Br. Prot. Prut No. Data Datum Date
01-2963/15 29.09.2015	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.09.2015, mori:

V E N D I M

I. *Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-2494/15, për z. Zafir Berisha, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, duke u larguar nga personi i autorizuar në biznesin privat.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2494/15,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Zafir Berisha, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjesës së konstatuar se zyrtari i lartë z. Zafir Berisha, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtarë i lartë, është i angazhuar në veprimtari private si person i autorizuar në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 20.08.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë njoftuese se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posdon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Berisha, ka kontaktuar nëpërmes telefonit me zyrtarët e AKK-së, për ta aranzhuar një takim për tu informuar për procedurën që është filluar nga AKK-ë.

Me datën 23.09.2015 zyrtaret e AKK-së kanë pritur ne takim z. Berisha dhe e kanë njoftuar më faktet dhe gjendjen në të cilën ndodhet z. Berisha.

Ne takim zyrtari i lartë z. Berisha pasi ka dëgjuar faktet e prezantuara nga zyrtarët e AKK-së është arsyetuar se qe nga momenti qe është zgjedhur ne funksion publik ka autorizuar një person që të udhëheq me biznesin e tij ku është pronar, por mund ndodhe qe nuk janë bërë ndryshimet në ARBK, por është zotuar se brenda afatit ligjor do ta bej ndryshimin në ARBK-ë dhe do të largohet nga pozita personit të autorizuar ne ketë biznes .

Me datën 28.09.2015, nga zyrtari i lartë z. Zafir Berisha, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Zafir Berisha, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin me emër N.SH.T “KESHTJELLA” me numër biznesi 70262314.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Zafir Berisha dukë bërë ndryshimet sipas kërkesës së AKK-së, ne biznesin e tij ku ka vepruar si person i autorizuar, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shhangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për z. Zafir Berisha, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

